

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Desada Metaj denoncon Celibashin për mesazhe intimiduese, reagon Asociacioni i gazetarëve
ADRESA	https://versus.al/aktualitet/desada-metaj-denoncon-celibashin-per-intimidim-pas-artikujve-per-tend-i46762
BURIMI	versus.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 13:45:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 13:33:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0f9e4cfb7428fbc2f33a3459e1ab9bb6093ea50d5fb22e6fef11bb342d84db24
TEKSTI	6c65ec386d93874c0ece42c0d1670dd218ac57b2a8ee8b1a464041fa0f1c1b93
PAMJA	b40cff37c7b51ac85e87a999c715ec71a07238e39b91d9cfd23fcb5321e273cd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2f49358e9f008aeeb5529f0f91290fe3214c3f70b6160aba7b41a11b47cae291
E MËPARSHMJA	2fa33788bfb25b67c77259822a7f62a17580ad2d392bd2a0ece10c174fa3141
RRËNJA MERKLE	565145c81569d96b39079f1db9ed9e378c0d0ec132a26687d139f465bf7be21b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2f49358e9f008aeeb5529f0f91290fe3214c3f70b6160aba7b41a11b47cae291>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[Protestë masive në Prishtinë kundër vendimit të Hagës, djemtë e liderëve të UÇK: Nuk dorëzohemi, politikanët të bëhen bashkë](#)

18 Shtator 2026, 13:00

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[AKTUALITET](#) / 18 Shtator 2026, 15:33

Desada Metaj denoncon Celibashin për mesazhe intimiduese, reagon Asociacioni i gazetarëve

Në një status në rrjetet sociale, Metaj, shkruan se është kontaktuar personalisht nga kryetari i KQZ-së, z. Ilirjan Celibashi, lidhur me këto shkrime.





Gazetarja Desada Metaj, ka denoncuar kreun e KQZ-së Ilirjan Celibashi se i ka dërguar mesazhe intimiduese në lidhje me shkrimet e bëra ndaj institucionit që ai drejton.

Në një status në rrjetet sociale, Metaj, shkruan se është kontaktuar personalisht nga kryetari i KQZ-së, z. Ilirjan Celibashi, lidhur me këto shkrime.

"I kam bërë të qartë se VNA është e gatshme të publikojë çdo sqarim zyrtar të KQZ-së për procedurat e tenderit, për aq kohë sa ai sqarim vjen institucionalisht dhe lidhet me faktet e publikuara. Por një sqarim i tillë nuk erdhi", shkruan më tej gazetarja duke vijuar se ka mësuar se z. Celibashi ka thirrur në zyrë subjektin që nuk ka fituar tenderin.

"Pas këtij takimi, pronari i këtij subjekti, Granit Gjana, më ka telefonuar për të më thënë se z. Celibashi i kishte kërkuar të më kontaktonte, me qëllim që unë të mos merresha më me të.

Ndërkohë, z. Celibashi më ka dërguar mesazhe dhe më ka telefonuar me një gjuhë që, për mendimin tim, nuk i shkon një zyrtari të lartë shtetëror, aq më pak drejtuesit të institucionit që administron zgjedhjet në Republikën e Shqipërisë", thotë gazetarja Desada Metaj.

Në lidhje me këtë, ka reaguar Asociacioni i Gazetarëve i cili ka shprehur mbështetjen ndaj gazetares Desada Metaj.



ASOCIACIONI I GAZETARËVE TË SHQIPËRISË
ASSOCIATION OF JOURNALISTS OF ALBANIA

DEKLARATË



Desada Metaj

12 minuta · 22

Reagim i detyruar...

Dje VNA publikoi dy shkrime investigative lidhur me një tender në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Të dy shkrimet janë mbështetur në dokumente dhe në të dhëna zyrtare, të verifikueshme.

Pas publikimit, jam kontaktuar personalisht nga kryetari i KQZ-së, z. Ilirjan Celibashi, lidhur me këto shkrime. I kam bërë të qartë se VNA është e gatshme të publikojë çdo sqarim zyrtar të KQZ-së për procedurat e tenderit, për aq kohë sa ai sqarim vjen institucionalisht dhe lidhet me faktet e publikuara.

Një sqarim i tillë nuk erdhi.

Në vend të tij, sot kam mësuar se z. Celibashi ka thirrur në zyrë subjektin që nuk ka fituar tenderin. Pas këtij takimi, pronari i këtij subjekti, Granit Gjana, më ka telefonuar për të më thënë se z. Celibashi i kishte kërkuar të më kontaktonte, me qëllim që unë të mos merresha më me të.

Dua të sqaroj publikisht se nuk e njoh z. Granit Gjana dhe se ai nuk është personi që është ankuar në VNA për problematikën e tenderave në KQZ.

Ndërkohë, z. Celibashi më ka dërguar mesazhe dhe më ka telefonuar me një gjuhë që, për mendimin tim, nuk i shkon një zyrtari të lartë shtetëror, aq më pak drejtuesit të institucionit që administron zgjedhjet në Republikën e Shqipërisë.

E siguroj z. Celibashi se nuk më intimidon as me gjuhë juridike, as me presione politike, as me telefonata jashtë çdo standardi institucional.

Nëse z. Celibashi mendon se ka një problem me shkrimet e VNA-së, rruga është shumë e thjeshtë: të dërgojë një sqarim zyrtar, të paraqesë dokumente, ose t'u drejtohet institucioneve të drejtësisë. Për çdo rast, mesazhet dhe telefonatat me të mund t'i vë në dispozicion të drejtësisë.

Me drejtësinë, z. Celibashi ka më shumë afri profesionale.

Unë, ndërkohë, do të vazhdoj t'i qëndroj besnike të vërtetës dhe dokumenteve. **Shiko më pak**

"Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë është njohur me pretendimet e gazetares Desada Metaj, sipas së cilës, pas publikimit nga VNA të dy shkrimeve investigative mbi një procedurë tenderimi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ajo është përballur me telefonata dhe mesazhe nga kreu i KQZ-së, z. Ilirjan Celibashi, si dhe me një përpjekje për ta kontaktuar përmes një subjekti të përfshirë në tender.

Çdo zyrtar publik ka të drejtën të kundërshtojë një raportim, të paraqesë dokumente dhe të kërkojë korrigjimin e pasaktësive. Megjithatë, komunikimi duhet të jetë institucional, transparent dhe pa gjuhë apo veprime që mund të perceptohen si presion ndaj gazetarëve. Përpjekja për të ndikuar nëpërmjet personave të tretë, , është e papranueshme dhe cenon rëndë pavarësinë editoriale", thuhet në reagimin e ASGSH-së.

Poll



AKTUALITET

[Mazhoranca miratoi formulën e pagave, magjistratët nuk tërhiqen: Do e çojmë në Kushtetuesë!](#)

18 Shtator 2026, 15:26

^ekstrakti^



AKTUALITET

["O Hashim, ti ku je, UÇK-në këtu e ke", ish-luftëtarët e UÇK-së mbërrijnë në Durrës pas Hagës](#)

18 Shtator 2026, 15:05

^ekstrakti^





AKTUALITET

Garancia prej 24 mijë paund nuk i hyn në punë shqiptarit në Angli, vijon procesi i ekstradimit

18 Shtator 2026, 14:30

^ekstrakti^



AKTUALITET

"Do të llogariten edhe kilometrat", dogana njofton rregulla të reja për zhdoganimin e automjeteve

18 Shtator 2026, 14:11

^ekstrakti^




AKTUALITET

E trishtë/ Deputeti socialist humb bashkëshorten: Dashuria ime që 18 vjeç, shpirti im binjak, sot na la vetëm

18 Shtator 2026, 13:52

^ekstrakti^



AKTUALITET

Rrugorja 'nuk fal'! Mbi 6800 gjoba brenda 3 ditëve në Tiranë, hiqen dhjetëra leje qarkullimi

18 Shtator 2026, 13:18

^ekstrakti^





AKTUALITET

[Ish-drejtoresha dyshohet se vodhi 700 mijë € të pensionistëve, burri i saj rritet në detyrë në bashkinë e Durrësit](#)

18 Shtator 2026, 12:10

^ekstrakti^



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.